



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Tiranë

VITI 2019

Tabela e Përmbajtjes

GJETJET KRYESORE	3
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË TIRANË.....	4
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	6
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	11
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN ETYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA.....	19
REKOMANDIME.....	21

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2019.

Gjetjet Kryesore

- Gjykata e rrethit Tiranë ka regjistruar 146 raste për lëshim urdhër mbrojtje dhe 798 raste për lëshim urdhër mbrojtje i menjëhershëm;
- Përgjatë vitit 2019 pranë policisë Tiranë janë evidentuar 1231 raste të dhunës në familje, nga të cilat 988 ishin viktimë gra/vajza si dhe janë plotësuar 704 kërkesë padi për urdhëra mbrojtje;
- Pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për bashkinë e Tiranës për vitin 2019 janë regjistruar 469 procedime për dhunën në familje sipas nenit 130/a/1,2,3,4;
- Bashkia Tiranë ka organizuar 12 takime ndërgjegjësuëse, u përfshinë në total 302 persona, me target grupe të ndryshme përfituese;
- Bashkia e Tiranës vijon të operojë në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit të mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij të nënshkruar në korrik 2018;
- Përgjatë vitit 2019 Koordinatorja Vendore pranë kësaj bashkie ka marrë pjesë në 8 trajnime;
- Bashkia Tiranë ka organizuar përgjatë vitit 8 takime konsultuese dhe vlerësuese për përmirësimin e funksionimit të Mekanizmit të Referimit në trajtimin e çështjeve të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore;
- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, Bashkia Tiranë në bashkëpunim me institucionet dhe OJF-të pjesë të Mekanizmit të Referimit ka mbështetur 643 raste të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore;
- Është përditësuar sistemi Revalb me 346 Raste të dhunës në familje;

- Janë organizuar 14 mbledhje të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar për trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;
- Drejtoria e Strehimit Social pranë kësaj bashkie ka trajtuar me bonus qeraje 9 raste, viktima të dhunës në familje;
- Strehëza për gra dhe vajza ka trajtuar 47 raste (gra, vajza dhe fëmijë);
- Linja e Këshillimit për Gra dhe vajza ka kryer 861 senaca këshillimi (ballë për ballë) dhe ka pritur 3014 telefonata;
- 1208 ishtë numri i viktimave të rasteve të dhunës në familje që kanë përfituar pagesën e ndihmës ekonomike prej 3000 lekësh nga pajisja me UM në 24 Njësitë Administrative, për vitin 2019;
- Për periudhën janar- dhjetor 2019, pranë zyrës vendore të Shërbimit të Provës Tiranë kanë hyrë 136 urdhra ekzekutimi;
- Gjatë vitit 2019, 82 ishin klientët që u trajtuan nga Linja e Këshillimit për burra dhe djem.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Tiranë

Të dhënat statistikore nga Gjykata e rrethit Tiranë¹

Sipas të dhënave zyrtare nga Gjykata e Tiranës, për çështjet civile gjatë periudhës kohore 1.1.2019 – 31.12.2019 kjo gjykatë ka regjistruar 146 raste për lëshim urdhër mbrojtje dhe 798 raste për lëshim urdhër mbrojtje i menjëhershëm. Janë 1914 raste të reja që janë paraqitur pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë si padi për zgjidhje martesë.

Po kjo gjykatë në çështjet penale për të njëjtën periudhë, ka regjistruar 303 raste të reja të dhunës në familje sipas nenit 130/a/1,2,3,4. Specifikisht të ndara si vijon:

Neni 130/a/1 – 162 raste të reja

Neni 130/a/2 – 12 raste të reja

Neni 130/a/3 – 20 raste të reja

Neni 130/a/4 – 109 raste të reja.

²Të dhëna statistikore nga Drejtoria e Policisë Tiranë

¹ Burimi: <http://ëëë.gjykatatirana.gov.al/>

² Burimi: Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Tiranë ka në përbërjen e saj 5 komisariate të cilat janë nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë, specifikisht Komisarjati nr. 1, nr.2, nr.3, nr.4 dhe nr.6. Të gjitha të dhënat mbledhen e më pas përpunohen në Drejtorinë vendore të Policisë së qarkut Tiranë.

Përgjatë vitit 2019, janë evidentuar 1231 raste të dhunës në familje, nga të cilat 988 viktimat ishin gra/vajza. Ndërkohë që numri i rasteve të veprës penale “dhunë në familje” neni 130/a për vitin 2019 ishte 384 dhe u arrestuan 152 autorë.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019, sipas Ligjit 9669, datë 18.12.2006, janë plotësuar 704 Kërkesë Padi për Urdhëra Mbrojtje. Nga DVP Tiranë gjatë periudhës 12 mujore të 2019-tës janë referuar 7 raste dhune në familje në “Për Këshillimin e Grave dhe Vajzave të Dhunuara” për tu ndihmuar me trajtim ligjor falas.

Të gjitha komisarjatet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë janë informuar dhe dërguar letër porosi për Masat që do të merren dhe dokumentacionin që do të plotësohet në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Udhëzimet e Përbashkëta të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë & Mbrojtjes Sociale, Nr.866, datë 20.12.2018 “Për miratimin e modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje” dhe Nr.912, datë 27.12.2018 “Për miratimin e modelit dhe të procedurave për Urdhërin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme”. Gjithashtu kjo drejtori ka koordinuar punën me komisarjatet përkatëse, me Qendrën e Pritjes së Viktimave të Dhunës në familje, dhe Bashkinë Tirane, në 12 raste.

Detaje më të hollësishme të ndara sipas komisarjateve përkatëse pjesë e drejtorisë së policisë Tiranë, pasqyrohen si vijon më poshtë:

Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Tiranë

	K.P. Nr.1 Tiranë	K.P. Nr.2 Tiranë	K.P. Nr.3 Tiranë	K.P. Nr.4 Tiranë	K.P. Nr.6 Tiranë	TOTAL
Evidentuar	199	190	242	366	234	1231
Të dëmtuar gjithsej	212	199	254	392	248	1305
Prej tyre gra/vajza	161	142	190	307	188	988
Kërkesë për U.Mbrojtje	118	121	126	212	127	704
Shkelje U.Mbrojtjes	4	4	3	13	13	37
V. P. Neni 130/a	60	51	82	112	79	384
Arrest. për 130/a	18	24	31	45	34	152
Ndaluar për 130/a	5	3	2	9	3	22
Gjendje të Lirë për 130/a	40	22	41	61	44	208
Në kërkim për 130/a	5	6	6	6	4	27
Autorë të vetëvrarë	0	0	0	0	1	1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

³Të dhëna statistikore nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Sipas informacioneve zyrtare të përfituara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për bashkinë e Tiranës për periudhën 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2019 janë regjistruar 469 procedime për dhunën në familje sipas nenit 130/a/1,2,3,4 nga të cilat janë regjistruar 351 procedime penale. 68 persona nën hetim, 234 të pandehur dhe kryer 107 arrestime.

Në vijim, 295 kallzime janë proceduar në gjyq, me 319 të pandehur dhe me arrestim të 92 autorëve.

Tabela 2. Dhuna në familje në Prokurorinë e Tiranë

Neni	130/a1	130/a2	130/a3	130/a4	TOTAL
Kallzime	418	6	3	42	469

Burimi: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Tiranë, për vitin 2019 nëpërmjet Sektorit të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në bashkëpunim me institucionet e linjës kanë organizuar një sërë fushatash ndërgjegjësuere për promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe në familje. Fushatat ndërgjegjësuere janë trajtuar nga ky sektor në formatet më gjithëpërfshirëse dhe inovative, duke nxitur pjesëmarrjen masive të qytetarëve, të të rinjve, sektorit privat, institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kjo bashki në bashkëpunim me organizatën “Sot për të Ardhmen” ka realizuar takime me vajza dhe gra-viktima të dhunës në familje dhe përfaqësues të njësive administrative me temën “Fuqizimi ekonomik dhe dhuna në marrëdhëniet familjare”. Dhe në Bashkëpunim me Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza dhe Organizatën “Plan and Go” ka organizuar seminare informuese mbi Barazinë Gjinore, dhunën në familje dhe trafikimin e fëmijëve pranë shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit në Njësitë Administrative të zonave rurale.

Sipas takime ndërgjegjësuere, u përfshinë në total 302 persona, me target grupe të ndryshme përfituese si gra, viktima të dhunës në familje, gra në nevojë, fëmijë dhe të rinj, anëtarë të mekanizmit si dhe Specialistë të Sektorit të Shërbimeve Sociale pranë Njësive Administrative.

Përgjatë periudhës 12 mujore të 2019-të, Bashkia Tiranë organizoi specifikisht aktivitetet e mëposhtme:

5 Takime me fokus fuqizimin ekonomik dhe monitorimin e dhunës në familje, pranë Njësive Administrative 2,3,4,7 dhe 8;

2 takime konsultuese me gra dhe vajza pranë njësive Administrative Ndroq dhe Dajt, me në fokus monitorimin e rasteve të dhunës në familje pas situatës së prekur nga tërmeti dhe zëri i grave në prioritetet e Njësive;

³ Burimi: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë

5 Takime informuese dhe ndërgjegjësuere mbi Barazinë Gjinore, dhunën në familje dhe trafikimin e fëmijëve në 5 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit përkatësisht:

- Shkolla “Mëzez-Fushë, njësia administrative Kashar;
- Shkolla 9-Vjeçare“Pezë e Vogël”, njësia administrative Pezë.
- Shkolla e mesme “Sadi Nuri”, njësia administrative Ndroq.
- Shkolla e mesme e bashkuar ”Feti Vogli”, njësia administrative Baldushk.
- Shkolla e mesme “Shëngjegj”, njësia administrative Shëngjergj.

8 Sesionet informuese të realizuara në bashkëpunim:

- Strehëza për Gra dhe Vajza dhe Bashkia Tiranë për Administratorët Shoqërorë dhe Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve në lidhje me ndryshimet e Ligjit *“Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”*;
- Strehëza për Gra dhe Vajza në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale të Bashkisë Tiranë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë ka zhvilluar një cikël takimesh ndërgjegjësuere në komisariate mbi *“Ndryshimet ligjore në ligjin për masat ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”* me punonjës policie dhe punonjës të shërbimeve sociale në njësi administrative;
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza me temë *“Fuqizimi ekonomik dhe zhvillim profesional i viktimave të dhunës në familje”* për anëtarët e Mekanizmit;
- UN Women dhe INSTAT në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë kanë organizuar seminarin informues me temë: *“Fuqia e të dhënave dhe mënyra se si të dhënat mund të përdoren për të mbështetur planifikimin dhe zbatimin e politikave sociale në nivelin lokal. Prezantim mbi gjetjet e sondazhit të fundit mbi Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri”*;
- Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në bashkëpunim me Qendrën për të Drejtat e Grave Rome, Aleancën kundër Diskriminimit të Komunitetit LGBT dhe Bashkinë Tiranë organizuan sesionin informues *“Për një qasje gjithëpërfshirëse në shërbime ndaj grave e vajzave të dhunuara nga komuniteti Rom/Egjyptian, LGBTI dhe atyre me aftësi të kufizuara”*, me staf të shërbimit social pranë njësive administrative dhe punonjës socialë pranë Qendrave Sociale dhe Komunitare të Bashkisë Tiranë.

Për organizimin e aktiviteteve për vitin 2019, Bashkia Tiranë vijon të ketë bashkëpunime me:

1. Strehëza për Gra dhe Vajza
2. QDNJD
3. QZHK Sot për të Ardhmen
4. Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza
5. Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem

Bashkia e Tiranës vijon të operojë në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit të mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij (korrik 2018).

Kjo marrëveshje ka si objekt koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve autoritare përgjegjëse në territorin e Bashkisë Tiranë për trajtimin e çështjeve të dhunës në familje, me anë

të mekanizmit referues. Qëllimi i saj është përmirësimi i vazhdueshëm i nivelit të sigurisë së anëtarëve të komunitetit dhe sigurimi i mirëqënies për kategoritë e personave që janë viktime të dhunës në familje përmes sistemit të reagimit të koordinuar.

Përgjatë vitit 2019 Koordinatorja Vendore pranë kësaj bashkie ka marrë pjesë në disa trajnime të organizuara, të listuara si vijon më poshtë:

- **21 Shkurt 2019**, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me UNDP, organizuan Takimin Rajonal të Koordinatorëve Vendorë kundër dhunës në familje të Bashkive të zonës veriore të vendit, për t'u njohur me ndryshimet e fundit ligjore të Ligjit 9669 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, për detyrimet ligjore që rrjedhin nga këto ndryshime, si dhe për aktet nënligjore që janë hartuar, për të siguruar një mbrojtje më efektive të viktimave të dhunës në familje;
- **9–10 Mars 2019**, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me UNDP, organizuan workshopin dy ditor për Ofrimin e Shërbimeve në Qendrën e Menaxhimit të Krizës në Rastet e Dhunës Seksuale, Qendra Liliun. Trajnimi u zhvillua me përfaqësues nga Koreja, të cilët sollën ekspertizën e tyre për të shqyrtuar një qasje efektive në sigurimin e mbështetjes së orientuar ndaj viktimave, bazuar në përvojat praktike dhe mësimet e nxjerra nga Qendra e Lulediellit në Seul të Koresë;
- **11 Mars**, Trainimi për sistemin REVALB i cili u zhvillua pranë zyrave të drejtorisë së Shërbimit Social Tiranë, me kërkesë të sektorit tek Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku ekspertët që kanë kriuar Sistemin REVALB të UNDP-së zhvilluan trajnimin për Koordinatorën Vendore të Bashkisë Tiranë dhe Koordinatorën e Vaut të Dejës;
- **15-24 Maj**, Trajnim me tematikë “Të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet” dhe shkëmbim eksperiencash për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke u fokusuar dhe në çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje, në Hagë, Hollandë;
- **30 Tetor 2019** Seminar / trajnim në lidhje me funksionimin e mekanizmave të referimit dhe çështje të strehimit social, me prezencë të ekspertes nga Anglia Znj. Rebeça Vagi e cila prezantoi modelin anglez në lidhje me çështjen, pranë sallës së trajnimeve të Bashkisë Tiranë, organizuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC);
- **12-13 Nëntor**, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, dhe me mbështetjen e UNDP Shqipëri me fonde të Qeverisë Suedeze, organizuan trainimin dy-ditor me temë: “Dhuna në familje dhe roli i autoriteteve përgjegjëse”.
- **18 Nëntor**, Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë organizuan trajnimin që kishte si synim të informimin mbi përgjegjësitë dhe mundësitë e bashkive dhe strukturave komunitare për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- **11-13 Dhjetor**, Përmbyllje e trajnimit “Të drejtat e Njeriut dhe Minoritetet”, Prezantim i funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, Shkup, Maqedoni.

Bazuar në rekomandimet pas çdo vit monitorimi, Bashkia Tiranë ka organizuar përgjatë vitit 2019 disa takime konsultuese dhe vlerësuese për përmirësimin e funksionimit të Mekanizmit të Referimit në trajtimin e çështjeve të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore:

- **8 Maj 2019**, është realizuar mbledhje e Grupit Teknik Ndërsektorial mbi monitorimin dhe vleresimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, Ministria e Shëndetit dhe Mirëqënies Sociale dhe UNDP
- **19 Korrik 2019**, pjesëmarrje në tryezën e konsultimit për një ligj të integruar kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, UT, organizuar nga UNDP
- **1 Tetor 2019**, pjesëmarrje në Tryezën e konsultimit për përmirësimin e bazës së të dhënave për çështjet e dhunës në familje- si një mjet për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës, pranë Ministrisë së Drejtësisë, organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me UNDP;
- **18 Tetor** pjesëmarrje në Tryezën e validimit të raportit “Funksionimi i Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të Dhunës në Familje- Arritjet, sfidat dhe ndërhyrjet në të ardhmen”, organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe UNDP;
- **30 Tetor** pjesëmarrje në seminarin e organizuar në lidhje me funksionimin e mekanizmave të referimit dhe çështje të strehimit social, me prezencë të ekspertes nga Anglia Znj. Rebeça Vagi e cila prezantoi modelin anglez në lidhje me këte, pranë sallës së trajnimeve të Bashkisë Tiranë, organizuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC);
- **1 Nëntor**, Takim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të diskutuar problematikat që shfaqen gjatë trajtimit të rasteve të dhunës, organizuar nga Sektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore Bashkia Tiranë dhe anëtarë të Mekanizmit;
- **9 Dhjetor**, pjesëmarrje në Seminarin përmblyës "Funksionimi i mekanizmave të referimit të rasteve kundër dhunës me bazë gjinore në Bashkitë Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë dhe Elbasan, pranë Hotel Tirana International, organizuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC).
- **23 Dhjetor**, koordinim dhe pjesëmarrje në seminarin informues në lidhje me funksionimin e Mekanizmit të Referimit.

Tabela 3. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizua nga:
1	5.2.2019	Njësia Administrative nr. 2	Fuqizimi Ekonomik dhe Monitorimi i dhunës në familje	Bashkia Tiranë
2	13.2.2019	Njësia Administrative nr. 3	Fuqizimi Ekonomik dhe Monitorimi i dhunës në familje	Bashkia Tiranë
3	19.3.2019	Njësia Administrative nr. 4	Fuqizimi Ekonomik dhe Monitorimi i dhunës në familje	Bashkia Tiranë
4	18.4.2019	Njësia Administrative nr. 7	Fuqizimi Ekonomik dhe Monitorimi i dhunës në familje	Bashkia Tiranë
5	18.4.2019	Njësia Administrative nr. 8	Fuqizimi Ekonomik dhe Monitorimi i dhunës në familje	Bashkia Tiranë
6	26.4.2019	Shkolla “Mëzez-Fushë Njësia Administrative Kashar	Takime informuese dhe ndërgjegjësuese mbi Barazinë Gjinore, dhunën në familje dhe trafikimin e fëmijëve	Bashkia Tiranë

7	23.10.2019	Shkolla 9-Vjecare“Pezë e Vogël”, Njësia Administrative Pezë	Takime informuese dhe ndërgjegjësuese mbi Barazinë Gjinore, dhunën në familje dhe trafikimin e fëmijëve	Bashkia Tiranë
8	23.10.2019	Shkolla e mesme “Sadi Nuri”, Njësia Ad,ministrative Ndroq	Takime informuese dhe ndërgjegjësuese mbi Barazinë Gjinore, dhunën në familje dhe trafikimin e fëmijëve	Bashkia Tiranë
9	6.10.2019	Shkolla e mesme e bashkuar” Feti Vogli”, Njësia Administrative Baldushk	Takime informuese dhe ndërgjegjësuese mbi Barazinë Gjinore, dhunën në familje dhe trafikimin e fëmijëve	Bashkia Tiranë
10	5.11.2019	Shkolla e mesme “Shëngjegj”, Njësia Administrative Shëngjergj	Takime informuese dhe ndërgjegjësuese mbi Barazinë Gjinore, dhunën në familje dhe trafikimin e fëmijëve	Bashkia Tiranë
11	26.10.2018	Ambjentet e Njesisë Administrative BËRZHITË	Trajnim për ndryshimet e reja ligjore me administratorët shoqërorë, PMF-të dhe specialistët e NE të Njësive Administrative Krrabë, Baldushk, Petrelë dhe Bërzhitë	Bashkia Tiranë dhe Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”
12	12.11.2018	Ambjentet e Njesisë Administrative VAQARR	Trajnim për ndryshimet e reja ligjore me administratorët shoqërorë, PMF-të dhe specialistët e NE të Njësive Administrative Kashar, Vaqarr, Pezë dhe Ndroq	Bashkia Tiranë dhe Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”

Gjatë vitit 2019, Bashkia Tiranë ka bashkëpunuar në mënyrë të ngushtë me një numër organizatash fetare si Fondacioni “Firdeus” dhe Fondacioni “Mirënjohja”, me të cilat ka nëshkruar marrëveshje bashkëpunimi 2 vjeçare. Me anë të këtyre bashkëpunimeve të vendosura janë ndihmuar shumë familje në nevojë duke përfshirë dhe raste të dhunës në familje, me paketa të ndryshme ushqimore, pagesë qiraje e të tjera të ngjashme.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Tiranë, në zbatim të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i ndryshuar, VKM-së nr. 334, datë 17.02.2011 “Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të Tij”, ka ngritur Mekanizmin e Referimit në Tiranë në maj 2012.

Gjithashtu në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016-2020, Bashkia Tiranë ka përgjegjësi të drejtpërdrejta në këtë plan veprimi, kryesisht në qëllimet 3 & 4:

Qëllimi Strategjik 3: *Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje*

Qëllimi Strategjik 4: *Fuqizimi i rolit koordinues dhe monitorues të Mekanizmit Kombëtar të Barazisë Gjinore*

Spektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore menaxhon dhe ndihmon rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore duke siguruar mbrojtje, informim, strehim, këshillim psikologjik dhe ligjor dhe koordinim me të gjithë aktorët e rrjetit, këto në interes të viktimës.

Ky Mekanizëm reagon menjëherë dhe me përgjegjësinë e duhur me shërbimet e mëposhtme të cilat janë falas për të mbijetuarat e dhunës në familje:

1. Mbështetje multidisiplinare për të mbijetuarat/it e dhunës në marrëdhëniet familjare;
2. Strehim social (bonus qiraje, mbulim qiraje 2-3 muaj nga organizata bashkëpunëtore);
3. Këshillim psikologjik dhe ligjor;
4. Mbështetje të rasteve të dhunës në familje pranë institucioneve përkatëse: Gjykatë, Polici; Përmbaram, Prokurori etj;
5. Aktivitete ndërgjegjësuëse dhe informuese të komunitetit;
6. Linjën Kombëtare të Këshillimit 24 orësh 116 dhe 117 pritëse, këshilluese dhe referuese të rasteve të dhunës në familje;
7. Këshillim për djem dhe burra përmes Linjës së Këshillimit për Djem dhe Burra;
8. Paketa të ndryshme ushqimore, veshmbathje, higjieno-sanitare etj

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, Bashkia Tiranë në bashkëpunim me institucionet dhe OJF-të pjesë të Mekanizmit të Referimit ka mbështetur 643 raste të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore:

- **34** raste në total – viktima të dhunës në familje të mbështetura nga Spektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore nëpërmjet Mekanizmit të Koordinuar të Referimit;
- **39** raste në total – viktima të dhunës në familje të trajtuara dhe referuara nga Drejtoria Vendore e Policisë (përpos rasteve të pajisuara me UMPMM/UMM/UM të cilat janë në një numër të lartë) përgjatë periudhës Janar-dhjetor 2019;
- **6** raste në total – viktima të dhunës në familje të trajtuara dhe referuara nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, nga të cilët dy janë raste fëmijë të dhunuar nga

bashkëmoshatarët dhe katër raste vajza dhe gra janë dhunuar nga bashkëshortët apo partnerët e tyre, përgjatë periudhës Janar-Nëntor 2019;

- **40** raste në total – të trajtuara në Qendrën për Menaxhimin e Krizës për Rastet e Dhunës Seksuale, Qendra “LILIUM“, përgjatë periudhës 4 Dhjetor 2018 – 31 Dhjetor 2019;
- **79** raste në total – viktima të dhunës në familje të mbështetura nëpërmjet mbështetjes psikologjike nga Qendra për Zhvillim Komunitar „Sot për të Ardhmen“, përgjatë periudhës Janar-Nëntor 2019;
- **263** raste në total – viktima të dhunës në familje të trajtuara nga Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci, nga të cilat **111 raste** janë përfaqësuar falas në Gjykatë, përgjatë periudhës Janar-Nëntor 2019;
- **117** raste në total – viktima të dhunës në familje aplikantë dhe përfitues të Ndhmës Ekonomike nga Urdhri i Mbrojtjes për muajin Dhjetor 2019;
- **47** raste-viktima të dhunës në familje të trajtuara nga Strehëza për Gra dhe Vajza Tiranë;
- **18** raste-viktima të dhunës në familje të pajisura me UM, nga të cilët 15 raste janë gra dhe vajza që kanë rënë viktima të dhunës në familje, të cilët janë regjistruar në Zyrën e Përmbarrimit Tiranë.

Gjatë vitit 2019, Bashkia Tiranë nëpërmjet anëtarëve të mekanizmit të referimit ka operuar si vijon:

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, specifikisht Sektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore:

- Të përditësojë Sistemin REVALB, 346 Raste të dhunës në familje;
- Të organizojë 14 mbledhje të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar për trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;
- Të koordinojë për realizimin e 8 sesioneve informuese për rritjen e kapaciteteve të punonjësve që punojnë me rastet e dhunës në familje;
- Të realizojë në bashkëpunim me institucione anëtare të mekanizmit 5 takime informuese dhe ndërgjegjësuese në shkolla mbi barazinë gjinore, dhunën në familje dhe trafikimin e fëmijëve;
- Të realizojë në bashkëpunim me Institucione Anëtare të Mekanizmit 6 takime me vajza dhe gra në njësi administrative me synim informimin, konsultimin dhe monitorimin e dhunës me bazë gjinore dhe në familje.

Drejtoria e Strehimit Social:

- Të trajtojë me Bonus Qiraje 9 raste të dhunës në familje;
- Të ofrojë informacion tek rastet e tjera të dhunës në familje për dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar për bonus qiraje.

Drejtoria e Nxitjes së Punësimit:

- Të zhvillojë intervista për ndërmjetësim punësimi për raste në nevojë duke përfshirë dhe rastet e dhunës në familje.

Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”:

- 79 raste-gra dhe vajza viktime/ të mbijetuara të dhunës në familje përmes këshillimit psikologjik;
- 45 raste referimi dhe bashkëpunimi me institucione të tjera qeveritare dhe joqeveritare-anëtare të Mekanizmit të Referimit;
- Mbi 150 të rinj të ndërgjegjësuar përmes aktiviteteve dhe fushatave ndërgjësuese.
- Ka frekuentuar takimet periodike me grupin GTN-së organizuar nga Koordinatorja Vendore për Dhunën në Familje pranë Sektorit të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në Bashkinë Tiranë.

Qendra për Të Drejtat e Njeriut në Demokraci:

- Ka arritur të trajtojë: 263 raste të dhunës në marrëdhëniet familjare, nga të cilat 111 raste janë përfaqësuar falas në Gjykatë;
- Ka ofruar mbështetje për rastet e dhunës në familje që ka konsistuar në ofrimin e shërbimeve ligjore falas si psh. Konsulencë ligjore, hartim dokumentacioni ligjor, përfaqësim në Gjykatë në çështjet me objekt lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, konfirmimin e Urdhërit të Mbrojtjes dhe Ndryshimin e Urdhërit të Mbrojtjes.
- Rastet e trajtuara nga QDNJD gjatë kësaj periudhe kohore janë referuar nga Komisaritet Nr.2,4, 5 dhe 6, Zyra për të Miturit dhe Dhunën në familje pranë Drejtorisë së Policisë Tiranë, Njësia Administrative Nr.3,4, 6, 8, Bashkia Tiranë, Bashkia Kamëz etj.
- Ka frekuentuar takimet periodike të GTN-së, organizuar nga Koordinatorja Vendore për Dhunën në Familje pranë Sektorit të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në Bashkinë Tiranë.

Strehëza Për Gra dhe Vajza (SAWG):

- Ka trajtuar 47 raste (gra, vajza dhe fëmijë) të cilat kanë marrë shërbimin e plotë në Strehëzë: strehim, mbështetje psiko sociale, mbështetje ligjore, regjistrim në kurset e formimit profesional/punësim, shoqërim i fëmijëve në çerdhe/kopësht/shkollë, etj.
- Ka ofruar rreth 500 seanca këshillimi individuale për gra dhe vajza;
- Ka organizuar dhe ofruar rreth 57 këshillime në grup për gratë në strehëz, të cilat mund të ndihmojnë dhe mbështesin njëra-tjetrën për të gjetur zgjidhje dhe gjithashtu për të marrë një arsim bazë;
- Ka ofruar rreth 40 seanca informuese për gratë dhe vajzat në strehimore me fokus në kornizën e re ligjore të dhunës në familje dhe shërbimeve në vend;
- Ka referuar 78% të rasteve tek shërbimet e tjera në komunitet, në mënyrë që të kenë mbështetje të vazhdueshme dhe të jenë në gjendje të jetojnë një jetë të sigurt përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit;
- Ka frekuentuar takimet periodike të GTN-së organizuar nga Koordinatorja Vendore për Dhunën në Familje pranë Sektorit të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në Bashkinë Tiranë.

Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza:

- Ka pritur 3014 telefonata dhe janë kryer 861 seanca këshillimi ballë për ballë. Rreth 62% e telefonatave kanë qenë nga gra dhe vajza, banore të qarkut Tiranë.
- Shumica e telefonatave kërkojnë ndihmë dhe mbështetje për të adresuar dhunën ose abuzimin, informacion mbi ndihmën ekonomike, vend pune, etj.
- Gjatë periudhës së raportimit dhuna e ushtruar ndaj klienteve që kanë telefonuar ose kanë marrë këshillim ballë për ballë ka qenë kryesisht e natyrës psikologjike (1778 raste), fizike (1657 raste), ekonomike (964) dhe seksuale (8 raste)⁴.
- Ka ofruar gjithashtu këshillim paraligjor dhe parësor për më shumë se 700 gra dhe vajza, si dhe shoqërim në gjykatë dhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore për një numër të kufizuar viktimash.
- Ka frekuentuar takimet periodike të GTN-së organizuar nga Koordinatorja Vendore për Dhunën në Familje pranë Sektorit të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në Bashkinë Tiranë.

⁵1208 ishte numri i viktimave të rasteve të dhunës në familje që kanë përfituar pagesën e ndihmës ekonomike prej 3000 lekësh nga pajisja me UM në 24 Njësitë Administrative, për vitin 2019, specifikisht të ndara si vijon:

Muajt	Jan	Shk	Mar	Prl	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nen	Dhje	Tot
Perfitues	79	94	89	94	94	105	96	102	117	110	115	113	1208

Në mbledhjet e GTN-së gjatë vitit 2019 morën pjesë përfaqësuesit e shumicës së institucioneve anëtare të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, konkretisht:

1. Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë,
2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,
3. Prokuroria e Rrethit Tiranë,
4. Zyra e Përmbartimit Tiranë,
5. Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë,
6. Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë,
7. Spitali (QSUT) Tiranë,
8. Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë,
9. Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë,
10. Zyra Rajonale e Punësimit Tiranë,
11. Strehëza për Gra dhe Vajza Tiranë,
12. Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”.
13. Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci” (*përfshirë në MKR gjatë vitit 2017 përmes një Marrëveshje Bashkëpunimi*)
14. Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (*është përfshirë në MKR përmes një Marrëveshje Bashkëpunimi e cila u konsultua me të gjithë anëtarët e Mekanizmit dhe u nënshkrua nga të gjitha palët në Korrik 2018*)

⁴ Numri i telefonatave nuk përkon me shumën 3014 pasi në shumë raste janë hasur dy ose më shumë tipe të dhunës në të njëjtin rast

⁵ Shërbimi Social Shtetëror

15. Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem (është përfshirë në MKR përmes një Marrëveshje Bashkëpunimi e cila u konsultua me të gjithë anëtarët e Mekanizmit dhe u nënshkrua nga të gjitha palët në Korrik 2018)

Koordinatorja vendore pranë bashkisë Tiranë informon me anë të njoftim zyrtar via e-mail datën dhe orën e saktë para çdo mbledhje, si dhe minutat e takimit apo informacione shtesë sipas rastit pas çdo mbledhje. Këto janë raporte që shpërndahen në mënyrë të rregullt duke përmirësuar kështu një pikë komunikimi që më përpara nuk ishte njësoj e respektuar.

GTN dhe bashkëpunëtorët (Komisariatet e Policisë, Njësitë Administrative, OJF të ndryshme etj.) marrin pjesë në procesin e vlerësimit të rastit dhe angazhohen për zgjidhjen e tij. Institucionet janë nxitur dhe rekomanduar të jenë pjesëmarrëse aktive në menaxhimin e rasteve si dhe të koordinojnë punën me njëra-tjetrën në mënyrë që të mund t'u shërbejnë sa më mirë të mbijetuarve të dhunës në familje në radhë të parë, por edhe anëtarëve të tjerë të familjes të prekur nga dhuna, që shpesh kanë probleme të thella ekonomike-sociale. Me përjashtim të Prokurorisë së Rrethit Tiranë, të gjitha institucionet e tjera marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e GTN-së ose në aktivitete të tjera të përbashkëta.

Sistemi REVALB është përditësuar vazhdimisht. Mirëpo nuk ka funksionuar shumë mirë në disa aspekte⁶:

- Printimi i raporteve mujore, tre-mujore apo më shumë nuk ka funksionuar asnjëherë
- Janë në proces disa azhurnime në këtë sistem përsa i përket ndryshimeve ligjore.
- Vështirësi dhe sfidë është mbledhja e të dhënave të plota, duke qenë se ka mungesë në Specialistë të Dhunës në Familje pranë Njësisë Administrative.

Shqetësimet e mësipërme sidomos në lidhje me funksionimin e sistemin online janë përçuar tek ekspertët e këtij sistemi në mënyrë periodike.

Bashkia Tiranë ka tashmë 24 njësi administrative në varësi. Hedhja në sistem e numrit të madh të rasteve të dhunës për Tiranën nuk mund të bëhet në kohë reale vetëm nga një person sepse tanimë njësia vendore është shumë më e gjerë dhe patjetër duhet të ketë një lidhje shumë të ngushtë me administratorët shoqërorë, që janë në ndarjet më të vogla.

Nevojat e viktimave të dhunës në familje janë të shumta. Me kalimin e viteve janë shtuar edhe shërbimet e ofruara ndaj kësaj kategorie. Megjithatë arritjet e MR dhe reagimit të koordinuar të tij, ka ende problematika dhe sfida për trajtimin me sukses të rasteve të dhunës në familje.

Në këtë kuadër Bashkia e Tiranës ka nxjerrë në pah disa pika të cilat janë problematika të mëdha për ecurinë dhe zgjidhjen e këtyre rasteve. Pothuajse në të gjitha trajtimet e rasteve, çështja e strehimit, sidomos për periudhën 24- 48 orë deri në lëshimin e UMM/UM është një prej problematikave kryesore. Por strehimi mbetet problem edhe kur rasti kërkon zgjidhje afatgjatë. “Strehëza për Gratë dhe Vajzat” është një ndër aktorët kyç sa i takon Mekanizmit të Referimit, pasi mbulon nevojat bazë për strehim të rasteve emergjente që janë në dhunë ekstreme. Megjithatë, ndonëse ka këtë funksion, jo çdo rast që shpreh nevojën për strehim mund të strehohet në Strehëz. Ka kritere dhe procedura specifike që aplikohen për çdo rast prandaj, jo

⁶Burimi: Koordinatorja Vendore pranë Bashkisë Tiranë

gjithmonë ofrohet mundësia e strehimit (*si për shkak të mos plotësimit të këtyre kriterëve, ashtu edhe për shkak të kapacitetit/infrastrukturës së limituar që ka kjo Strehëz*). Rekomandohet që për Bashkinë Tiranë të ketë një qendër të sajën strehimi.

Pavarësisht se, Bashkia Tiranë nuk ka një Strehëz emergjence (0-48 orë) për viktimat e dhunës në familje, synon mbështetjen e qendrave të specializuara për ofrimin e shërbimeve riintegruese për trajtimin e rasteve - viktimat të dhunës në familje si dhe të fëmijëve të tyre, përmes mbulimit të një pjese të kostove të shërbimeve. Gjithashtu, në bazë të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “*Për Programet Sociale për Strehimin e Banorëve të Zonave Urbane*”, i ndryshuar; udhëzimit nr. 23, datë 30.12.2008 “*Për Përbajtjen e Bonusit të Strehimit*”, Bashkia Tiranë, u jep përparësi kërkesave për strehim social të viktimave të dhunës në familje dhe personave me të ardhura nën minimumin jetik ku përfshihen dhe gratë.

Bashkia Tiranë vazhdon të hasë problematika në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe shërbimeve specifike për të adresuar nevojat e kësaj kategorie.

Gjithashtu sfidë për këtë bashki mbetet edhe raportimi i dhunës në zonat rurale, pasi shumë raste dhune në zonat rurale nuk raportohen. Për ta adresuar këtë problematikë, Bashkia Tiranë në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të Mekanizmit vijon të organizojë takime ndërgjegjësuese të vazhdueshme me komunitetin e njësive të reja administrative.

Sipas Bashkisë Tiranë, një tjetër vështirësi që haset për këtë kategori, është ajo e trajtimit afatgjatë të viktimave të dhunës përmes punësimit pasi në raste të shumta ato nuk duan të punojnë por preferojnë ndihmë ekonomike. Në këtë drejtim, Bashkia e Tiranës si institucioni koordinues i MR Tiranë, ka vendosur urat e bashkëpunimit me ofruesit e shërbimeve të formimit profesional; duke i kushtuar vëmendje të veçantë projekteve të nxitjes së punësimit, me qëllim fuqizimin social ekonomik të grave dhe vajzave vulnerabël në përgjithësi dhe vajzave dhe grave që kanë pësuar dhunë në veçanti.

Përveç pagës së Koordinatorës Vendore, Mekanizmit i Referimit dhe trajtimit të rasteve të DHBGJ&DHF po fuqizohet përmes buxhetimit nga Bashkia Tiranë të shërbimeve të specializuara, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe Konventës së Stambollit. Konkretisht Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza pjesë e MKR Tirane është mbështetur edhe gjatë vitit 2019.

Gjatë vitit 2019 koordinatorja Znj. Nadire Myrta ka zëvendësuar Znj. Bojaxhi e cila e mbante këtë detyrë që prej vitit 2013. Ajo ka mbajtur marrëdhënie të pandërprera me Përgjegjësin e Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Znj. Myrta është e ngarkuar edhe me detyra dhe përgjegjësi të tjera përgjatë kryerjes së punës së Koordinatorës vendore.

Kontrata e Znj. Myrta me Bashkinë Tiranë është si Specialiste e përkohshme e Sektorit të përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, duke mbuluar në këtë sektor edhe rolin e Koordinatorës Vendore për Dhunën në Familje.

Në Bashkinë Tiranë, inspektore për barazinë gjinore dhe dhunën në familje është vetë shefja e këtij sektori znj. Aida Shehu. Por, përveç barazisë gjinore znj. Shehu mbulon edhe çështje të tjera të përfshirjes sociale si Komuniteti Rom dhe ai Egjiptian.

Sipas monitorimeve dhe raportimeve, bashkëpunimi i këtij mekanizmi me institucionet përgjatë vitit 2019 ka qenë optimal për pjesën më të madhe të institucioneve anëtare të mekanizmit. Vlerësohet dhe shihet një bashkëpunim mjaft i mirë me përfaqësuesit e Zyrës Rajonale të Punësimit, Qendrës për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen", Drejtorisë Vendore të Policisë, Strehëzës për Gra dhe Vajza Tiranë, Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza dhe Linjës së Këshillimit për Burra dhe Djem, Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror, Qendrës "Të Drejtat e Njeriut në Demokraci", Autoritetit Shëndetësor Rajonal Tiranë, Gjykatës së Rrethit dhe Spitalit (QSUT) Tiranë.

Duke vazhduar më tej me përfaqësuesit e institucioneve të cilët kanë qenë më pak prezentë në mbledhje gjatë vitit 2019, si përfaqësuesit nga Zyra Arsimore Vendore dhe nga Zyra e Përmbarrimit Tiranë. Për arsye të largimit të punonjësve nga pozicioni i punës pranë dy institucioneve përkatëse anëtare, ishin ndërprerë marrëdhëniet e bashkëpunimit. Në vijim të situatës së krijuar, pas kërkesës institucionale të kësaj bashkie kundrejt institucioneve të sipërpërmendura për rivendosje bashkëpunimi në përcaktimin e punonjësve të rinj përgjegjës për frekuentimin e mbledhjeve të GTN-së dhe në muajt fundit të vitit 2019 është rivendosur bashkëpunimi.

Ndërkohë që përfaqësuesit e institucioneve të cilët nuk kanë qenë prezent në mbledhje gjatë vitit 2019, janë përfaqësuesit e Prokurorisë së Rrethit dhe të Mjekësisë Ligjore.

Tabela 4. Numri i mbledhjeve të GTN-së ne vitin 2019 në Bashkinë Tiranë

Data	Vendi	Temat
30.1.2019	Bashkia Tiranë	Trajtim rastesh të referuara si dhe një bashkërendim I punës për vijueshmërinë e vitit.
28.2.2019	Bashkia Tiranë	Trajtimi I rasteve të referuara pranë Bashkisë Tiranë
15.3.2019	Bashkia Tiranë	Trajtimi I rasteve të referuara pranë Bashkisë Tiranë
25.4.2019	Bashkia Tiranë	Trajtimi I rasteve te referuara gjatë muajit Prill.
8.5.2019	Bashkia Tiranë	Takim informues për të gjithë aktorët e mekanizmit të referimit dhe jo vetëm, por edhe për NGO që operojnë për këtë çështje, për egzistencën e qendrës "Lilium" active që nga dhjetor 2018.
24.5.2019	Bashkia Tiranë	Në takim u diskutuan rastet e grave të dhunuara të cilat përballen me vështirësi të mëdha për t'u riintegruar në shoqëri. Anëtarët pjesëmarrës të ETN-së diskutuan mundësitë e institucioneve që përfaqësojnë për të ndihmuar në ofrimin e shërbimeve për trajtimin efektiv të rasteve të paraqitura. Si, dhe u trajtuan 7 raste
27.6.2019	Bashkia Tiranë	
8.8.2019	Bashkia Tiranë	U diskutua dhe vlerësua ecuria e rasteve të dhunës të trajtuara gjatë

		muajve të fundit, si dhe për të trajtuar dhe referuar rastet aktuale të dhunës në familje .
6.9.2019	Bashkia Tiranë	Trajtimi I raateve të referuara pranë Bashkisë Tiranë
3.10.2019	Bashkia Tiranë	Takimi i GTN u organizua për referimin, diskutimin dhe vlerësimin e ecurisë së rasteve të dhunës të trajtuara nga Mekanizmi gjatë muajve të fundit.
7.11.2019	Bashkia Tiranë	Takimi I rradhës i Grupit Teknik Ndërsektorial për referimin, diskutimin dhe vlerësimin e ecurisë së rasteve të dhunës të trajtuara nga Mekanizmi gjatë muajve të fundit. Përveç trajtimit të rasteve të dhunës në takim morën pjesë dhe përfaqësues të Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve për të prezantuar projektin e tyre dhe pyetësin për anëtarët e ETN-së në lidhje me menaxhimin e rasteve të dhunës nga mekanizmi.
27.11.2019	Bashkia Tiranë	Per zgjidhjen e një rasti të ripërsëritur dhe të ri-referuar në bashki.
19.12.2019	Bashkia Tiranë	Trajtimi dhe diskutimi i një rasti për zgjidhje B.A.
23.12.2019	Bashkia Tiranë	Ritrajtim I rastit B.A

Ndërkohë, po njësoj si një vit më parë, në Bashkinë Tiranë nuk është organizuar asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues për vitin 2019.

Tabela 5. Këshlli Drejtues bashkia Tiranë

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Erjon Veliaj, Kryetar
Drejtoria e Policisë	Kastriot Skenderaj, Lindita Lushaku, Elena Hasango
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Enkelejd Hajro, Alba Nikolla
Prokuroria e Rrethit	Dritan Rreshka
Drejtoria Arsimore Rajonale	Ajola Byzyka, Edlir Tërpo
Drejtoria e Shëndetit Publik	Dritan Ulqinaku, Rudina Basha
Zyra e Përmbartimit	Enea Dyrmishi, Dorina Saja

Tabela 6. GTN-ja e Bashkisë Tiranë viti 2019

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Anjeza Bojaxhiu
Drejtoria e Policisë	Elena Hasango
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Alba Nikolla
Prokuroria e Rrethit	Dritan Rreshka
Drejtoria Arsimore Rajonale	Edlir Tërpo
Drejtoria e Shëndetit Publik	Rudina Basha
Zyra e Përmbartimit	Dorina Saja
Prefektura	Nuk ka
Kryetarët e Njësive Administrative	Nuk ka
Zyra e Punësimit	Vera Mborja

Organizata Jo qeveritare	Migena Ismailati
Strehëzat për viktimat e dhunës	Marsela Allmuça
Komunitete fetare	Nuk ka
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk ka

Burimi: Bashkia Tiranë

Në Bashkinë e Tiranës janë Specialistet e policisë së zonës në komisaritet përkatëse ata që plotësojnë UM dhe UMM-es. Në pjesën më të madhe të rasteve punonjësi përgjegjës i Njesisë Administrative është prezent në komisaritet dhe bashkërendon punën me specialistin e policisë së zonës. Ndërkohë që gjatë këtij viti nuk është plotësuar asnjë i tillë nga Bashkia Tiranë.

Bashkia Tiranë përmes punonjësve të trajnuar për çështjet e dhunës në çdo Njësi Administrative vazhdimisht referon raste të dhunës tek Strehëza Kombëtare. Si rrjedhojë gjatë vitit 2019 janë referuar më shumë raste seç ka patur kapacitet Strehëza⁷ pasi problem kryesor për bashkinë gjatë trajtimit të rasteve të dhunës, siç është përmendur edhe më sipër, mbetet gjithmonë çështja e strehimit, sidomos për periudhën 24-48 orë deri në lëshimin e UMM/UM. Por strehimi mbetet problem edhe kur rasti kërkon zgjidhje afatgjatë. Jo çdo rast që shpreh nevojën për strehim mund të strehohet në Strehëz. Ka kritere dhe procedura specifike që aplikohen për çdo rast prandaj dhe jo gjithmonë ofrohet mundësia e strehimit, si për shkak të mos plotësimit të këtyre kritereve, ashtu edhe për shkak të kapacitetit/infrastrukturës së limituar që ofron kjo Strehëz.

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin etyre, përmes programeve të specializuara.

Sipas informacioneve të publikuara në faqen zyrtare të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo gjykatë përgjatë vitit 2019 ka pranuar lëshimin e 68 UM dhe 390 UMM. Ndërkohë që për veprën penale “Dhunë në Familje” të parashikuar në nenin 130/a të Kodit Penal, kjo gjykatë shpalli të fajshëm 290 dhunes.

Për periudhën janar- dhjetor 2019, pranë zyrës vendore të Shërbimit të Provës Tiranë kanë hyrë 136 urdhra ekzekutimi për të mbikqyrur të dënuar për veprën penale të 'Dhunë në familje', parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, të gjithë të gjinisë mashkull dhe moshës madhore. Të gjithë urdhrat e ekzekutimit të specifikuar sipas veprave penale apo të dhënave të tjera, i përcillen Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës sipas nje formati të miratuar me një frekuencë mujore.

Në kuadër të bashkëpunimit që Shërbimi i Provës ka me Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem, për këtë vit janë trajtuar 15 raste, ndërsa numri i rasteve të referuara është më i lartë, por një pjesë e tyre e kanë refuzuar këtë shërbim.

⁷Burimi: Koordinatorja Vendore

Për rastet e referuara, është ofruar këshillim. Numri i takimeve ka qenë i ndryshëm, kjo në varësi të frekuencës së caktuar nga specialistët e autorizuar për mbikqyrje. Moshë e klientëve varion nga 22-60 vjeç. Shumica e klientëve janë të moshës 35-45 vjeç, më së shumti të martuar me fëmijë, me arsim fillor ose të mesëm. Vetëm një numer i vogël, kanë arsim të lartë.

Klientët që kanë qenë pjesë e programeve të kësaj qendre, kanë raportuar se konflikti i tyre ka ardhur si pasojë e problemeve ekonomike, perfshirja e të afërmeve të tjerë në marrëdhëniet e tyre, abuzimi me alkoolin, xhelozinë, tradhëtinë dhe menaxhimin e zemërimit. Lidhur me qëndrimin që kanë për veprën penale për të cilën janë dënuar, ata e në përgjithësi e mohojnë, minimizojnë ose justifikojnë veten për dhunën e përdorur. Lloji i dhunës që kanë ushtruar më së shumti është ajo fizike, por nuk kanë munguar edhe rastet e llojeve të tjera të dhunës si: dhunë psikologjike, dhunë seksuale apo kërcënime.

Zakonisht viktimë e dhunës është partnerja. Ka patur raste me më shumë se një viktimë të dhunuar, si p.sh. kur partnerja është viktimë bashkë me fëmijët. Në disa raste viktimat janë prindërit por edhe fëmijët (zakonisht vajza).⁸

Ndërkohë që bashkia Tiranë, ka rinovuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Mekanizmin e Referimit në Korrik 2018 duke e përfshirë dhe Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem në kuadër të dhënies së mundësisë për rehabilitimin e dhunuesve përmes programeve të specializuara.

Gjatë vitit 2019, 82 ishin klientët që u trajtuan nga Linja e Këshillimit për burra dhe djem.⁹

Falë marrëveshjes së bashkëpunimit sqë LKBD ka me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, e cila përkon me periudhën Tetor 2017 – Tetor 2019, u është ofruar këshillim 82 individëve brënda Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) 313, IEVP 302 dhe së fundmi IEVP 327. Bashkëpunimi me IEVP 327 u bë i mundur pasi ky institucion u zhvendos në ambientet e IEVP 313

Gjatë vitit 2019 është bërë i mundur ofrimi i këshillimit të 82 personave të cilët kanë pranuar me dëshirë të marrin pjesë në këtë program. Numri i takimeve për secilin rast është i ndryshëm. Ai varion në bazë kohës së qëndrimit të tyre në IEVP dhe nevojave apo mundësive të personit për sa i përket IEVP-ve dhe në varësi të frekuencës që specialistët e shërbimit të provës ju kanë vendosor për sa i përket dhunuesve që ky institucion ka referuar tek Linja e Këshillimit.

Janar –Tetor 2019	IEVP 313, IEVP 302, IEVP 327	Sherbimi i Proves	Gjykata
Numri I rasteve të trajtuara	82	15	3

⁸ Burimi: Zyra e Shërbimit të Provës Tiranë

⁹ Burimi: Linja e Këshillimi për Burra dhe Djem

Mosha e klientëve varion nga 18 vjeç deri në 72 vjeç rasti më i vjetër. Shumica e klientëve janë nga 35 deri në 45 vjeç. Në mënyrë tipike ata janë burra të martuar me fëmijë, me arsim fillor ose të mesëm. Vetëm një numër i vogël i tyre kanë një diplomë universitare.

Dhunuesit që kanë marrë pjesë në shërbimet e Linjës së Këshillimit kanë raportuar se konflikti i tyre është kryesisht pasojë e problemeve ekonomike, përfshirja e të afërmeve të tjerë në marrëdhëniet e tyre, abuzimi me alkoolin, xhelozinë, tradhtinë dhe menaxhimin e zemërimit. Edhe pse përmendin disa nga arsyet e mësipërme të konfliktit të tyre, ata mohojnë, minimizojnë ose justifikojnë veten për dhunën e përdorur. Lloji i dhunës që ata kanë ushtruar më tepër ka qënë dhunë fizike, llojet e tjera të dhunës përfshijnë: dhunën psikologjike, dhunën seksuale dhe kërcënimet.

Viktima është zakonisht partnerja. Ndonjëherë nuk ka vetëm një viktimë, për shembull ka raste kur partnerja është viktimë së bashku me fëmijët. Në disa raste viktima janë prindërit, fëmijët (zakonisht vajza). Gjatë gjysmës së dytë të vitit, numri i rasteve që kanë përdorur dhunë ndaj prindërve të tyre është rritur. Vihet re në shumicën e rasteve janë të rinj të moshës 19 deri në 27 vjeç.

Përsa më sipër, LKBD ofroi dhe kreu 662 seanca, mesatarisht 8 seanca për klient. Ndërkohë që kategorizimi i tyre sipas moshës tregon se:

14 % e rasteve ishin të grupmoshës 18 – 25 vjeç;
grupmosha 26 – 35 vjeç zinte 22 % të rasteve të referuara,
40 % e tyre ishin të grupmoshës 36 – 45 vjeç;
19 % e rasteve zinin grupmoshën 46 – 55 vjeç
5 % të rasteve ishin të grupmoshës 56 – 67 vjeç.

Në total, 72 % e klientëve të kësaj linje kishin ushtruar dhunë fizike ndaj partneres dhe 23 % e tyre kishin ushtruar dhunë psikologjike.

¹⁰Zyra e përmbarimit në Tiranë ka egzekutuar 1579 raste me objekt “pension ushqimor”, 221 raste me objekt “takim fëmije” dhe 18 raste me objekt “urdhër mbrojtje”

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Tiranës për vitin 2019, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Tiranë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Rekomandohet rishikimi i modulit të Sistemi REVALB, me ndryshimet e reja në ligj dhe me azhornimet e herëpahershme ka sjellë problematika, sidomos në printimin e raporteve mujore apo 3-mujore, të cilat nuk kanë funksionuar përgjatë 2019.

¹⁰ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit

- Bashkia Tiranë njësoj si në vitin 2018 edhe këtë vit ka hasur problematika në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe shërbimeve specifike për të adresuar nevojat e kësaj kategorie. Ndaj rekomandohet që kjo çështje të diskutohet dhe të gjendet një zgjidhje afatgjatë sa më e shpejtë.
- Bashkia e Tiranës vijon të vuajë mungesën e një strehëze emergjence (0 – 48 orë) e cila do të lehtësonte adresimin e rasteve të referuara që kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme nga ana e mekanizmit të referimit.
- Sfidë për këtë bashki mbetet edhe raportimi i dhunës në zonat rurale, pasi shumë raste dhune në zonat rurale nuk raportohen, ndaj është e nevojshme ndërhyrja edhe më e madhe me fushata informuese dhe ndërgjegjësuese për këto zona.
- Çdo insitucion duhet të marrë pjesë në mbledhjet e GTN-së dhe të marrë përgjegjësi jo thjesht të marrë pjesë. Pjesëmarrja e Institucioneve si Prokuroria dhe Mjekësia Ligjore është një rekomandim që vijon të jepet edhe për këtë vit.
- Sikurse edhe për bashki të tjera të monitoruara paraqitet nevoja e adresimit të mundësive rehabilituese për dhunuesit dhe rritjen e rolit të bashkisë dhe institucioneve të tjera pjesëmarrëse në mekanizmin e referimit për ofrimin e këtij shërbimi.
- Bashkia e Tiranës duhet të alokojë buxhet të mjaftueshëm për aktivitete dhe material ndërgjegjësuese kundër dhunës në familje.
- MKR-ja Tiranë duhet të veprojë si një e tërë për të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore. Roli i çdo institucioni është shumë i rëndësishëm që rasti të marrë të gjithë ndihmën e duhur si viktimë, fëmijët por edhe dhunuesi.
- Gjatë mbledhjeve duke qenë se mbahen minutat dhe të përgatiten skedat e të dhënave për rastet konkrete, ato (rastet) të ndiqen deri në krijimin e bindjes se janë jashtë rrezikut të dhunuesit.
- Punësimi i grave të dhunuara mbetet një tjetër problematikë e kësaj bashkie. Megjithë vendosjen e urave lidhëse me aktorët e tjerë, pjesë të mekanizmit, punësimi i këtyre grave mbetet në shifra shumë të ulëta, ndaj rekomandohet që të punohet sa më shumë jo vetëm për formimin profesional por edhe për ndërgjegjësimin e tyre (grave të dhunuara) për të punuar dhe për të mos u varur ekonomikisht vetëm nga asistenca e bashkisë.